

*Dr. Sulltane KOJÇINI - UKAJ*

## **PROKLAMATA E ATDHETARIT ADEM SELIMI-GLLA VICA (TETOR 1945) TRONDITI PUSHTETIN E BRISHTË KOMUNIST**

### **Burrat që ndërruan rrjedhat e historisë**

Ngjarjet e rëndësishme kombëtare, varësisht nga rrethanat e kohës, u përfolën në mënyra të ndryshme nga historianë e publicistë. Në këto kushte, pa dyshim nuk ka qenë lehtë që shumë atdhetarëve dhe ngjarjeve historike t'u jepet vendi meritore në historinë tonë kombëtare dhe të mos i mbulojë pluhuri i harresës. Këto personalitete e ngjarje historike nuk ishin të harruara në kujtesën e popullit shqiptar i cili në çfarëdo rrethane diti t'i ruajë kujtimet për burrat që nderuan rrjedhat historike. Mosqasja me kohë e ndriçimit të ngjarjeve historike dhe bartësve të tyre në mënyrë shkencore ka krijuar hapësirë që në opinion të këtë mendime e vlerësime të ndryshme. Kësaj duhet shtuar edhe mungesën e dokumentacionit arkival përkatës për ndriçimin e ngjarjeve të caktuara historike që për një kohë të gjatë ishin nën embargo e sistemit komunist. Gjatë hulumtimeve tona në Arkivin e Kosovës, në kutinë e fondit Gjyqi i Qarkut Prishtinë 66/47, hasëm në një material arkival që kishte të bënte me aktivitetin e rezistencës kombëtare në vitet e para të pasluftës për bashkimin e tokave shqiptare, siç quhej në dokument "Organizatës Balliste". Materiali titullohej "Proklamata Balliste" e hartuar nga Adem Selimi-Gllavica.

Proklamata ishte mjaft përmbajtësore, kishte segmente të shumanëshme të historisë sonë kombëtare, e pasuruar me shumë të dhëna por kishte edhe porosi. Për ta ndriçuar edhe më shumë këtë dokument të rëndësishëm historik ishte e nevojshme të bëheshin edhe hulumtime plotësuese. Gjatë konsultimit të dokumentacionit arkival kuptova se për këtë Proklamatë ishin burgosur e keqtrajtuar shumë nacionalistë shqiptarë që i përkisnin krahut të rezistencës kombëtare, përkatësisht organizatës së NDSH-së, si Azem Morana e Hasan Bilalli, por edhe nacionalistë antifashistë të kyçur në strukturat e pushtetit të ri

komunist, si Abdullah Musliu etj. Nga materiali arkival për gjykimin dhe hetuesinë e të pandehurit Abdullah Musliu shihet se pas shumë bisedave në hetuesi, pas rrahjeve e keqtrajtimeve më çnjerëzore, Abdullah Musliu e kishte pranuar si të veten këtë proklamata, duke deklaruar: “E pranoj si timen proklamata në fjalë, të cilën e kam dërguar edhe në Shkup për ta shumëzuar, por e cila ka qenë në dorëshkrim dhe në gjuhën shqipe. Përmbajtja nga kjo që po e nënshkruaj nuk ndryshon, përveç që i mungojnë edhe disa parulla që kanë qenë të shtypura në shqip”.<sup>1</sup> Pranimin e dhunshëm Abdullah Musliu e bën në zyrat e UDB-së më 10. IV. 1947 në prani të udbashit hetues Miladin Paviçević. Kjo më shtyri të hulumtoj dosjen e tij të bazuar në procesin gjyqësor. Hetuesia e parë ishte zhvilluar më 28.XII.1946 në lokalët e Sigurimit Shtetëror në Frizaj dhe kishte filluar në orën 24. Tri ditë më parë në lokalët e Sigurimit Shtetëror në Shkup ishin marrë në pyetje edhe anëtarët dhe veprimtarët e dalluar të organizatës së NDSH-së për Shkup Azem Morana, Hasan Bilalli e Abdyl Qerimi, që ishin keqtrajtuar e rrahur për Proklamata. Abdullah Musliu, veç tjerash, në hetuesi ishte pyetur edhe për kontaktet e tija me Adem Gllavicën, Hasan Billalin dhe me Azem Moranën.

### **Kush ishte Abdullah Musliu?**

Abdullah Musliu ishte i lindur më 1919 në Talinoc. Që nga viti 1923 kishte jetuar në Shkup ku kishte mbaruar gjimnazin dhe më vonë kishte punuar. I kishte takuar Lëvizjes Përparimtare Studentore dhe për këtë aktivitet të tij ishte burgosur nga forcat bullgare në Shkup. Pas një kohe kishte arritur të ikte nga burgu dhe të inkuadrohej në Lëvizjen Antifashiste në Ferizaj. Forcat italiane i kishin rënë në gjurmë aktivitetit antifashist të tij, ndaj e kishin burgosur dhe internuar në kampin Porto Romano të Shqipërisë ku kishte qëndruar deri në kapitullimin e Italisë. Pastaj ishte kthyer në Ferizaj dhe ishte emëruar prefekt në Talinoc. Në këtë detyrë kishte qëndruar gjashtë muaj kur ishte burgosur nga gjermanët dhe ishte dërguar në kampin famëkeq të Vjenës. Pas mbarimit të Luftës ishte kthyer së pari në Shkup e pastaj në Ferizaj dhe ishte emëruar kryetar i Rrethit të Ferizajt.<sup>2</sup> Duke i parë padrejtësitë që i bëheshin popullit shqiptar në ditët e para të pasluftës, kishte qenë plotësisht i pakënaqur me politikën që zbatonin organet e pushtetit popullor të sistemit të ri komunist. Këtë pakënaqësi e shpreh edhe në hetuesi para organeve të Drejtoratit të Sigurimit Shtetëror me një guxim që rrallëkush mund ta kishte bërë në atë kohë. Në hetuesi Abdullahu kryesisht merret në pyetje rreth

<sup>1</sup> Arkivi i Kosovës, Fondi, Gjyqi i Qarkut Prishtinë, 66/47, (Dosja e Abdullah Musliut).

<sup>2</sup> Po aty, hetuesia e zhvilluar në Ferizaj më 28. XII.1946.

proklamatës që qarkullonte në popull dhe që ishte zënë nga Sigurimi Shtetëror Jugosllav. Pyetja e parë që iu bë Abdullahut kishte të bënte me kontaktet e tija me Adem Gllavicën. Ai në hetuesinë e parë ishte shprehur: "Një fshatar nga Llugaxhia, emri i të cilit nuk më kujtohet, ma ka sjellë Proklamatën në gjuhën shqipe në krye të së cilës shkruante: "Të shumëzohet në Shkup" dhe asgjë tjetër. Proklamata nuk ishte e nënshkruar nga askush, por unë e mora me mend se ajo duhej të ishte shkruar nga Adem Gllavica ngase ai ato ditë sillej nëpër fshatrat e Ferizajt". Pa e lexuar deri në fund, Abdullahu, sipas hetuesisë, ishte nisur për në Shkup që ta kryente detyrën dhe obligimin që kishte marrë për shumëzimin e kësaj proklamate. Në Shkup, në prani të Azem Moranës, Hasan Bilallit e të Abdyl Qerimit ishte lexuar tërësisht Proklamata dhe kishin filluar diskutimet rreth tekstit dhe porosive të saja, pohon në hetuesi Abdullah Musliu.<sup>3</sup> Sipas kësaj hetuesie, në takim me Azem Moranën dhe Hasan Bilallin, veç tjerash, ishte diskutuar edhe për situatën në Kosovë, të cilën Abdullahu e kishte cilësuar si të rëndë dhe dëshpëruese. Ai kishte thënë: "Në Kosovë po vriten shqiptarët, po keqtrajtohen dhe nuk është realizuar asgjë prej asaj që na është premtuar gjatë luftës".

Shumëzimi i Proklamatës ishte bërë nga Azem Morana dhe Hasan Bilalli. Ajo ishte shtypur në 18 kopje dhe nuk më kujtohet a më është kthyer origjinali, pohon në hetuesi Abdullah Musliu. Ai po ashtu deklaroi se Proklamatën e shumëzuar nuk e kishte sjellë në Kosovë, por të copëtuar e kishte hedhur në lumin Vardar. Mërepo, hetuesia nuk i kishte besuar atij, duke thënë se e njëjta proklamë është gjetur e shpërndarë në Kosovë. Sipas Abdullah Musliut, origjinali ka mbetur në Shkup dhe atë prapë e kanë shumëzuar anëtarët e organizatës së NDSH-së dhe kanë mundur ta shpërndajnë në Kosovë. Nga hetuesia e bërë ndaj Abdullah Musliut vihet në konstatim të bazuar se pushteti popullor asnjëherë nuk i ka besuar kuadrit shqiptar që punonte në kuadër të "pushtetit popullor", e që në numër ishte fare simbolik dhe ky ishte shkaku që ky kuadër të përcillej me syçëltësi nga organet përkatëse siç ishte UDB-ja.

Qëllimi ishte që në çdo mënyrë kuadrot shqiptare të zëvendësoheshin me ato serbe, duke i kualifikuar ato si të dyshimtë, nacionalistë, bashkëpunëtorë të bandave, reaksionarë e me shumë epitete tjera të shpikura nga organet e "pushtetit popullor", meqë shqiptari ishte gjithnjë i dyshimtë dhe i pabesueshëm për pushtetin e kohës. Pas marrjes në pyetje nga Sigurimi Shtetëror i Ferizajt, Abdullahun e dërgojnë në Prishtinë për ta shtuar trysinë ndaj tij me qëllim të marrjes së informatave të reja jo vetëm lidhur me proklamatën në fjalë, por edhe me organizatën e NDSH-së dhe bartësit e saj ku ishte i përfshirë edhe ai.

<sup>3</sup> A. K, 66/47, zapisnik o saslusanju 28.XII.1946.

### Gjendshmëria në dhënien e informatave në hetuesi

Do theksuar se Abdullah Musliu ishte shumë i gjendshëm në dhënien e informatave me dhunë në hetuesi. Ai vononte në dhënien e tyre deri sa sigurohej se luftëtarët e rezistencës dhe aktivistët e organizatës së NDSH-së ishin strehuar në ndonjë vend tjetër, apo edhe e kishin kaluar kufirin.

Edhe në hetuesinë e datës 9.II.1947 në lokalet e UDB-së në Prishtinë, ku Abdullahut i ishte bërë tryzni e madhe e përcjellë me provokime e dhunë të paparë për të pranuar atë që organet e pushtetit dhe UDB-ja ia servonin, ai sërish kishte shprehur pakënaqësinë dhe zhgënjimin në organet e pushtetit në të cilat edhe vetë ishte i kyçur. Pas kthimit nga internimi (në kampim e përqendrim të Vjenë) Abdullahu kishte shkuar fillimisht në Shkup e pastaj në Ferizaj dhe ishte kyçur në Këshillin e Rrethit. Që në fillim të punës kishte parë padrejtësitë që i bëheshin popullit shqiptar në emër të “barazisë” nacionale nga ana e pushtetarëve komunistë. Ai shprehet se “vizita e tij kampit të përqendrimit në Ferizaj i kishte lënë mbresa të rënda në kujtesë, kur kishte parë të grumbulluar 300-400 vetë më të cilët veprohej shumë keq. Aq më tepër ishte i mllëfosur në pushtetin që kishte lejuar që personat të cilët gjatë luftës kishin qenë armiq të më të mëdhenj të Lëvizjes Antifashiste, tash shëtisnin të lirë (çetniket e amnistuar në vitin 1943), ndërsa në anën tjetër ishin pushkatuar burrat më të mirë shqiptarë. Kjo ndjenjë dhe kjo pasqyrë e situatës pas luftës tek unë ka ngjallur dëshirën për vetëvrasje, shprehet Abdullahu në hetuesi, sepse nuk kam qenë në gjendje ta përballoj, e aq më pak kam pasur mundësi që të ndryshoj realitetin e krijuar. Në hetuesi po ashtu shprehet: “Unë e dua shumë popullin tim dhe zhgënjimi im pas lufte ka qenë si rrjedhojë e kësaj mosbarazie, kam dashur që populli im të jetë i barabartë me popujtë e tjerë të Kosovës. Pas sulmit mbi Ferizaj pushteti është hakmarrë ndaj burrave më të mirë shqiptarë që fare nuk ishin pjesëmarrës në atë sulm. Këtë e kanë bërë elementë shovinistë që janë fshehur pas yllit të kuq e që janë infiltruar edhe në pushtetin popullor.<sup>4</sup> Për këtë pakënaqësi ndaj pushtetit Abdullahu kishte biseduar edhe me Olga Glogovcin, sekretare e njësitit në Këshillin Popullor të Rrethit të Ferizajt, e cila, siç thotë Abdullahu, nuk ka ditur të përgjigjet nga kjo sjellje aq e egër e pushtetit popullor ndaj shqiptarëve. Një mendim të ngjashëm e ka shprehur edhe komunisti Boshko Çaqiq. “Ai kishte pranuar se ka sektarizëm ndaj shqiptarëve, por shqiptarët më të mirë janë të kyçur në organet e pushtetit. Pakënaqësia e theksuar e Abdullah Musliut ndaj pushtetit popullor, si dhe deklaratimet e shpeshta dhe shpeshherë edhe publike lidhur me këtë

<sup>4</sup> Po aty.

intensifikuan edhe më shumë mbikqyrjen e organeve përkatëse ndaj veprimeve dhe lëvizjeve të tij.

Abdullahu në hetuesi deklaroi se me Adem Gllavicën njiheshin shumë më herët kur që të dy vijonin mësimet në Shkup, Ademi në Medresenë e Shkupit, ndërsa Abdullahu në gjimnaz. Abdullahu ishte në dijeni për veprimet e Adem Gllavicës, për veprimtarinë e tij atdhetare, si dhe për formimin e forcave mbrojtëse të Kosovës. Në mesin e vitit 1945 Abdullahu kishte pasur një takim të rëndësishëm me Adem Gllavicën, i cili ishte realizuar me ndërmjetësimin e Ibrahim Cërnillës. Takimi në malet afër Cërnillës ishte mbajtur pa praninë e të tjerëve. Dy shokë të një ideali që kishin zgjedhur rrugë të ndryshme të realizimit të aspiratave të tyre kombëtare nuk ishin parë mes vete që nga viti 1941. Pas bisedave e konsultimeve rreth proklamats që duhej ta dërgonte, Adem Gllavica Abdullahut i kishte propozuar që të nisej së bashku me të dhe me grupin që e udhëhiqte për në Greqi. Kërkesën në fjalë Adem Gllavica e kishte justifikuar me faktin se Abdullahu kishte qenë pjesëmarrës në Lëvizjen Antifashiste, i burgosur dhe i dërguar në internim dhe tash ishte i pakënaqur me strukturat e pushtetit popullor. Largimi i grupit të Adem Gllavicës së bashku me Abdullahun, i cili kishte pranuar që ta shoqëronte në këtë rrugë, ishte dashur të bëhej menjëherë pas kthimit të tij nga Shkupi. Ademi po ashtu e kishte porositur Abdullahun që pa vonesë ta dërgonte këtë proklamats me anë të një fshatari nga Babushi që ishte edhe korier i Adem Gllavicës, dhe se ai duhej urgjentisht ta dërgonte në Shkup te Azem Morana dhe Hasan Bilalli, të cilët e kishin për detyrë që proklamats në fjalë ta shumëzonin në mënyrë që të shpërndahej në Kosovë. Kjo ishte koha kur Kuvendi i Prizrenit (8 korrik 1945) më parë ia kishte përcaktuar fatin Kosovës që të mbetej nën thundrën serbe dhe se grupet nacionaliste që vepronin gjatë luftës dhe pas saj, që diku ishin më të organizuara e diku më pak, varësisht nga rrethanat, bënë përpjekje të vepronin me të gjitha mjetet për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë (aspirata këto që ishin premtuar edhe nga komunistët gjatë LDBSU). Abdullahu pasi e kishte marrë Proklamats që ishte në dorëshkrim, ishte nisur për në Shkup dhe e kishte kryer detyrën e marrë nga Adem Gllavica, një personalitet me ndikim në Kosovë. Sipas deklaratës së Abdullahut, e cila gjithnjë duhet marrë me rezevë kur kemi parasysh metodat e UDB-së gjatë marrjes në pyetje, këtë Proklamats, pasi ishte shumëzuar nga Azem Morana dhe Hasan Bilalli, e kishte grisur dhe hedhur në lumin Vardar dhe, gjithnjë sipas tij, ajo ka mundur të depërtojë në Kosovë falë aktivitetit të Azem Moranës dhe Hasan Bilallit, dy veprimtarë të njohur të organizatës së NDSH-së.<sup>5</sup> Kjo ishte koha

---

<sup>5</sup> Zapisnik o saslusanju, 9.II.1947, (odelenje UDB-e Kosmet).

kur Adem Gllavica së bashku me grupin e tij prej 300 burrash ishte nisur për në Greqi, ndërsa kishin mbërrirë vetëm 150. Shumë prej tyre ishin vrarë në pritë e partizanëve maqedonas, por kishte raste të kthimit të tyre në Kosovë.<sup>6</sup>

Abdullah Musliu ishte marrë shpesh në biseda informative në hetuesi, sidomos në orët e natës, e kishte raste që ato të zgjasnin edhe nga ora 12 deri në orën 5 të mëngjesit. Në hetuesi më 10.02.1947 në lokalet e UDB-së në Prishtinë Abdullahu, veç tjerash, shprehet: “për të gjitha gabimet që janë bërë nga pushteti popullor ndaj popullit shqiptar kam humbur besimin në parti dhe në pushtet dhe jam gjendur në aso situatë që më është dashur të vendos, ose t’i përkrah nacionalistët që pushteti i quante “reaksonarë”, ose të jem kundër tij. Për luftë kundër krahut nacionalist të rezistencës kombëtare isha i pafuqishëm, sepse, siç kam cekur edhe më parë, e kisha humbur besimin të pushteti dhe të çdokush. Për këtë zgjedha rrugën tjetër më të pëlqyer, që do të thotë jam lidhur me “reaksionin” dhe me Adem Gllavicën. Oferta e tij për t’u nisur për Greqi më ka pëlqyer dhe unë e kam dhenë mendimin tim pozitiv.”<sup>7</sup>

### **Përmbajtja e Proklamatës kishte shqetësuar pa masë pushtetin komunist**

Në hetuesinë e 10.04.1947 në lokalet e UDB-së në Prishtinë Abdullahu ishte pyetur në detaje rreth përmbajtjes së Proklamatës dhe domethënies së saj. Ai kishte deklaruar së në fund të Proklamatës ishte nënshkruar Shtabi i Rezistencës Kombëtare-Adem Selim-Gllavica.

Nga kjo që u tha dhe bazuar edhe në deklaratat e Abdullah Musliut dhënë para organeve të hetuesisë, mund të konstatojmë se grupet nacionaliste të rezistencës kombëtare të shpërndara nëpër malet e Kosovës, por edhe ato që vepronin në strukturat e organizatave nacionaliste si NDSH-ja e të tjera, shfrytëzuan të gjitha mundësitë e një rezistence ushtarake e politike për ta ndryshuar pozitën e Kosovës. Në rrethanat e pavolitshme dhe në situatën e ndërlikuar që u krijua në Kosovë, kur mundësitë e veprimit nga sulmet e forcave partizano-çetnike u ngushtuan, grupet nacionaliste menduan strategjinë e largimit nga Kosova me qëllim edhe të veprimit nga jashtë, duke bërë përpjekje të shfrytëzonin edhe pakënaqësinë e aleatëve anglo-amerikanë me ndarjen e interesave në Ballkan. Kjo i shtyri grupet nacionaliste të shkapërdedhura nëpër malet e Kosovës që pas një rezistence

<sup>6</sup> Skender Zogaj, Jusuf Uka-Bregu luftëtar i paepur i Ballit Kombëtar, Prishtinë 2002, f. 43.

<sup>7</sup> Hetuesia e datës 10.02.1947, UDB Prishtinë.

aktive të gjejnë rrugën e braktisjes së vendit për të cilin kishin luftuar dhe derdhuer gjak në mënyrë që edhe nga kjo pozitë të bënin trysni të forcat ndërkombëtare, e veçmas të ato aleate anglo-amerikane dhe të kërkonin ndihmën e tyre për ndryshimin e statusit të Kosovës.

Komunistët me veprimet e tyre mashtruese zhgënjyen edhe atë pjesë të shqiptarëve që për një kohë u kishin besuar premtimeve boshe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo u hetua veçmas pas Konferencës së Bujanit.

Përmbajtja e kësaj Proklamate kishte shqetësuar pa masë “pushtetin popullor” komunist ende jostabil në Kosovë dhe e kishte nxitur atë të ndërmerre masa të ngutshme e të rrepta për pengimin e shpërndarjes së saj, duke i burgosur dhe dënuar me burgime të rënda e të gjata veprimtarët e rezistencës kombëtare.

Proklamata ishte shpërndarë kryesisht në lokalitetet ku vepronin aktivistët e NDSH-së, si në Bellaqec nga Azem Jashanica-Bellaqeci, në Bresje nga Nazif Bogujevci dhe në Lismir nga Isa Obërtinca etj. Sipas deklaratës së Stanoje Aksiqit, ajo ishte shpërndarë në orët e vona të natës dhe në mëngjes agjentët e UDB-së e kishin gjetur.<sup>8</sup>

### **Agjentët e UDB-së parandalojnë shpërndarjen e Proklamatës**

Që kjo proklamata të mos kishte shtrirje më të madhe në Kosovë UDB-ja kishte shpërndarë agjentët e vet në gjithë Kosovën për ta parandaluar shpërndarjen e mëtejme të saj sepse ajo konsiderohej e rrezikshme dhe me ndikim të populli shqiptar mu në kohën e zgjedhjeve. Të gjithë ata shqiptarë që mendonin kombëtarisht, qoftë edhe ata që ishin të kyçur brenda strukturave të pushtetit aktual, nga organet përkatëse komuniste u etiketuan si “banda”, “nacionalistë”, “irredentistë”, “reaksionarë”, “ballistë” etj. Ky etiketim, duke përfshirë edhe atë më të rëndin “trathtar i popullit”, vazhdoi të përdorej edhe në tekstet dhe në literaturën komuniste deri në kthesën e vitit 1990. Pas kësaj kohe filloi një rishkrim i historisë kombëtare, por edhe një qasje tjetër ndaj proceseve historike.

### **Teksti integral i Proklamatës së Ballit Kombëtar që botohet në tërësi për herë të parë**

Vëllezër kosovarë, ju drejtohem i sot, ne vëllezërit tuaj nga malet e liria të Kosovës. Kaluan dhjetë muaj në pritje të armatosur, kemi pritur me durim

<sup>8</sup> A.K. f.66/47, deklarata e Stanoje Aksiqit dhënë më 16.04. 1947, UDB-së në Prishtinë.

dhe kur është ndier nevoja kemi luftuar. Gjatë kësaj kohe i kemi hetuar dy veprime dhe masa të “çlirimtarëve”, dy kutë. Këto dy kutë ne i kemi ditur qysh në fillim prandaj edhe kemi shfaqur mendimin tonë për premtimet e tyre boshe, duke pritur që edhe të tjerët të binden. Tani edhe më naivët dhe simpatizantët e “çlirimtarëve” e kanë të qartë si qëndrojnë punët. Tash e kanë kuptuar realitetin e hidhur dhe tradhtinë e madhe që i është përgatitur popullit qysh gjatë Luftës së Dytë Botërore nga internacionalistët jugosllavë. Ne nuk na habisin qendrimet e serbëve e të malazezve. Ata janë të njëjtit që tradhtuan më 1878, 1912, 1918, e këta të fundit janë bijtë e tyre që janë më të moderuar për të përgatitur lojëra dhe janë të aftë të përgatisin “plane të djallit.”

Këtë ne nuk po e themi pa fakte, por po na çudit qëndrimi i disa shqiptarëve. Ata janë shndërruar në vegla të verbëra për interesa të huaja dhe e kanë okupuar e varfëruar deri në lëkurë popullin e vet shumë të përvuajtur. Popullit ia kanë marrë të gjitha e asgjë nuk i kanë dhënë, fakt i madh i barazisë dhe lirisë së popullit! për të cilat fraza kanë trumbetuar katër vjet. Pas lufte në mënyrë sistematike që 10 muaj i rekrutojnë të rinjtë dhe i dërgojnë jashtë Kosovës, më shumë se 70 mijë shqiptarë, pjesën më vitale të kombit. Në Brigadën VII Kosovare u mashtruan dhe u inkuadruan rreth 20 mijë shqiptarë. Të gjithë këta u futën në brigadë për çlirimin e Kosovës ngase iu thanë se do të mbesin në Kosovë dhe do të luftojnë për çlirimin e saj. Pas disa ditësh, të paarmatosur i dërguan në Banat. Sot janë të sistemuar në shumë brigada anembanë Jugosllavisë të vrarë e të masakruar dhe nuk iu dihet as varri. Më vonë është bërë edhe një mashtrim tjetër, duke tentuar që në mënyrë vullnetare të tubojnë ushtarë. Por vullnetarisht askush nuk iu shkoi. Atëherë e menduan formën tjetër të mashtrimit. Iu thanë se këta ushtarë do të shkojnë të shërbejnë në Shqipëri se po i kërkon Enver Hoxha. Këtu e prekën në shpirt shqiptarin. Kosovarët e pafat, të gatshëm të flijohen për Shqipërinë, u futën nëpër brigada partizane. Por tradhtia jugosllave nuk vonoi. I çarmatosën dhe i futën nëpër kazermat e Prizrenit që të mbushura me shqiptarë u kthyen në kampe përqendrimi, më të rënda se ato të fashizmit. Pas disa ditësh, të rinjtë shqiptarë i sistemuan në grupe të ndryshme “reaksiore dhe elementë fashistë”. Shumica prej tyre të zhveshur e të zbathur fituan sëmundjen e tuberkulozit duke qëndruar në çimenton e ftohtë të kazermave. Pjesën tjetër e çarmatosën, pa rroba, të zhveshur e të zbathur, nën përcjelljen e malazezve të armatosur, e nisën për në Shkodër. Të kaplon tmerri kur i shikon këta të rinj shqiptarë që nën tytën e pushkës së malazezve i nisën për në Shkodër. Më të fortit kundërshtuan dhe tentuan të iknin, por ranë pa shpirt, u qëlluan nga malazezë të armatosur. Rruga Prizren-Shkodër ato ditë i ka përmgjarrë kasaphanës. Disa më të fuqishmit arriten t’i çarmatosin rojat dhe të mësyjnë malet. Ata që arritën të

ikin na njoftuan për masakrën dhe sot janë pjesëtarë të batalioneve tona. Nga ata u njoftuam për tragjedinë e shqiptarëve të rinj e të paarmatosur për “mjeshtritë e partizanëve”. Kjo ndodhi ato ditë kur Haki Taha në Prishtinë vrau tradhtarin më të madh të popullit shqiptar, malazezin Miladin Popoviq. Kjo nuk mbeti me kaq. Forcat malazeze të egërsuara jashtë mase vranë 3.000 shqiptarë duarthatë. Kjo masakër do të zgjaste po të mos kishin qenë familjet nga Tivari që e penguan tragjedinë edhe më të madhe deri sa të vritej shqiptari i fundit...

Populli shqiptar në Kosovë përbën 85 për qind të popullsisë e vende-vende edhe 100 për qind. Gjuha zyrtare në Kosovë është gjuha serbe, ajo e 15 përqindshit të popullsisë. Kjo mund të quhet barazi!? Ne e kemi alfabetin tonë shumë të bukur dhe fare nuk na duhet cilirika sllave. Kjo nuk po ndodh në Slloveni, Kroaci e as në Maqedoni. Në mendojmë se futja e cilirikës në Kosovë është e qëllimshme. Për 10 muaj të “lirisë” së premtuar nga komunistët jugosllavë janë vrarë e pushkatuar 35 mijë shqiptarë emrat e të cilëve dhe vendi i vrasjes tashmë u janë të njohura të gjithëve. Këto janë metodat e pushtetit popullor për “liri të popullit”. Ka edhe raste të tjera të tmerrshme që populli ynë nuk i ka ditur. I thërrisnin romët që t’u bienin daulleve para burgjeve serbe derisa brenda qelive në mënyrat më çnëzore keqtrajtoheshin shqiptarët e pafajshëm, tortura këto që të çmendnin, si futja e bajonetave në trup, këputja e pjesëve të trupit me darë, thyerja e eshtrave e shumë të tjera. Krejt kjo bëhej që të mos dëgjoheshin britmat e shqiptarëve nga dhembjet e shkaktuara.

Plaçkitjet që partizanët ia bënë popullit shqiptar për ta varfëruar skajshmërisht, që të rezikohej edhe më vdekje për shkak të urisë, nuk janë të rralla. Shqiptarëve iu dogjën edhe shtëpitë me pretekstin se ata ishin “reaksonarë fashistë”. Çfarë ironie... Të njëjtit partizanë që plaçkitën dhe dogjën çdo gjë tash vijnë shtëpi për shtëpi dhe regjistrojnë dëmet e bëra nga vetë ata dhe mundohen t’i bindin gratë tona se këto dëme i kanë bërë gjermanët, pasi që burrat shqiptarë janë nëpër male. Populli shqiptar i shumëvuajtur nga regjimet serbe të mëparshme me gëzim priti “lirinë”, atë lirinë e barazinë e premtuar gjatë luftës, por përjetoi zullum, plaçkitje e vrasje që sot i di gjithë bota. Për “lirinë” e dhuruar nga pushteti popullor është i njoftuar i gjithë populli shqiptar. Prej shumë premtimeve që u dhanë gjatë luftës për vetëvendosje asgjë nuk është realizuar. Na mashtruan ngase ky popull i lodhur e i stërlodhur nga shumë regjime okupuese u besoi premtimeve të komunistëve. Kur u hetua tradhtia ne veç ishim të çarmatosur dhe bijtë tanë më të mirë i internuan dhe i degdisën nëpër skajet e Jugosllavisë. Ne ende i kemi të freskëta parullat e komunistëve të proklamuar gjatë luftës: “Populli shqiptar vetë do të vendosë me kë do të mbetet, me Shqipërinë, me Jugosllavinë ose republikë në vete.” Ditët e para

të këtij pushteti komisarët politikë të këtij regjimi në katër anët me oratori të zjarrtë flisnin për të drejtat dhe liritë, duke propaganduar dorëzimin e armëve. Populli i gjohtë, duke shpresuar në liri të plotë, filloi t'i dorëzojë armët duke menduar se më nuk do t'i nevojiten ngase erdhi liria.

Por ç'ndodhi pastaj! Të gjithë e dinë. Burgosje, vrasje, internime. Megjithatë, populli nuk e humbi shpresën. Pyesnin kur do të mbaheshin votimet që në mënyrë demokratike ta shprehnin vullnetin e vet që është bashkimi me Shqipërinë, ideal ky për të cilin shqiptarët kanë luftuar me shekuj. Komunistët për këtë synim të shqiptarëve e kanë ditur qysh gjatë luftës dhe për këtë kanë filluar ta këshillojnë popullin që të heqë dorë nga këto synime, duke thënë se duhet hequr dorë nga kjo "dëshirë e marrë". Premtimet zyrtare ranë në heshtje.

Më 1945 iu shit Kosova Beogradit nga djemtë e vet, Mehmet Hoxha e të tjerë. Prandaj, soleminisht deklarojmë se aneksimi i Kosovës Serbisë është kundër vullnetit të popullit shqiptar të Kosovës. Ne asnjëherë nuk e pranojmë këtë akt që e kanë nënshkruar disa individë të cilët nuk e përfaqësojnë popullin e Kosovës dhe as vullnetin e tij. Populli i Kosovës aq më pak e pranon Kuvendin e Prizrenit të mbajtur më 8 korrik 1945 ku janë ftuar disa persona nga tërë Kosova kinse si përfaqësues të popullit dhe janë detyruar të nënshkruajnë (pasi shumica prej tyre kanë qenë të burgosur të frikësuar e të kërcënuar) vendimin me të cilin Kosova jep pelqimin për futjen nën Serbinë federale. Populli shqiptar turpërohet nga këto vendime të papranueshme e të turpshme për të cilat asnjëherë nuk qe i konsultuar dhe i njoftuar, që është norma më elementare e demokracisë. Populli shqiptar i cili në Kosovë paraqet shumicën absolute kërkon të drejtën e vet të natyrshme - bashkimin me vëllezërit e vet, me Shqipërinë e vitit 1913. Kjo ka qenë, kjo është dhe do të jetë vullneti dhe synimi i popullit shqiptar të Kosovës. Ky vullnet dhe synim i popullit shqiptar nga "çlirimtarët" quhet imperializëm, shovinizëm e fashizëm, që askund në botë nuk ndodh, por ndodh dhe lejohet në Ballkan.

Në Istrie dhe Trieste jetojnë më pak se 20% e popullsisë sllovene dhe "çlirimtarët" përpiqen që këtë territor t'ia bashkangjesin Jugosllavisë. Këtë akt të tyre nuk e konsiderojnë si shovinizëm, imperializëm e fashizëm. (Gjenerali anglez Aleksandri, i shkruante Titos se pushtimi i kësaj krahine nga ana e Jugosllavisë ia përkujtonte pushtimet e Hitlerit). Këta "çlirimtarë", në anën tjetër, ia mohojnë vullnetin popullit shqiptar të Kosovës të bashkohet me Shqipërinë dhe marrin guximin që këtë dëshirë të tyre ta quajnë shovinizëm, imperializëm e fashizëm. Demokracia (po thonë se Jugosllavia e re është demokratike) ia mohon të drejtën popullit shqiptarë për bashkim, vallë kjo na qenka e drejta e popullit për vetëvendosje. Kjo e drejtë u është dhënë popujve nga Fuqitë e Mëdha në Kartën e Atlantikut dhe

në Konferencën e Kretës dhe atë të San Franciskos. Mirëpo, këto vendime për popullin shqiptar nuk kanë vlerë, ngase ky popull është i paarsimuar dhe nuk di se çka është demokracia, gjegjësisht “çlirimtarët e popullit” jo vetëm që nuk na konsiderojnë si shqiptarë, si komb, duke na i mohuar të gjitha të drejtat, por as që na vlerësojnë si njerëz. Kosova i ka përjetuar padrejtësitë në këta dhjetë muajt e shkuar nga ana e terroristëve me yllin e kuq në ballë. Kjo gjëti në një rrez, që bëhet kundër shqiptarëve të Kosovës për 10 muaj “çlirimi”, nuk zbatohet askund në botë, por në Kosovë nuk është kurrfarë risie pos përsëritje e historisë së viteve shoviniste, imperialiste e fashiste. Jugosllavia me plot gojën pohon se ka sistem demokratik, ndërsa në anën tjetër mohon të drejtat e një populli, siç është populli shqiptar, për vetëvendosje. A ka këtu diç nga demokracia?! Kjo e drejtë u është garantuar popujve më 1878, kur ardhacakët nga Beogradi (Karpitet) vranë dhe masakruan 100 mijë shqiptarë në Vilajetin e Nishit. Ata që arritën të ikin sot këtu quhen “muhaxhirë” të shpërndarë në të gjitha pjesët e Kosovës. Në vitin 1912, sërisht me urdhër të Beogradit, u pushkatuan hiq më pak shqiptarë se shifra e lartpërmendur. Në vitin 1918 gjatë formimit të Jugosllavisë mozaike, prapë me urdhër të Beogradit, u vranë dhe u pushkatuan me mijëra shqiptarë. Në atë kohë në Konferencën e Paqes është publikuar lista e 8000 viktimave, që është përcjellë me një protestë energjike. Por kjo është si gjithnjë “vok lajms in dezerta”.

**Katër data tragjike të historisë, katër regjime të ndryshme  
me një politikë të përbashkët: asgjësimi dhe shkatërimi  
i qenies shqiptare në Kosovë**

Më 1945 përsëritet historia. Prapë me udhëzimet e Beogradit bëhen masakra masive mbi popullin shqiptar. Ende pa kaluar 10 muaj janë evidencuar 35 mijë të vrarë e të masakruar dhe mbi 50 mijë të dëbuar për fatin e të cilëve nuk dihet. Këto janë fakte të hidhura. Katër data tragjike të historisë, katër regjime të ndryshme por me një politikë të përbashkët dhe identike e shumë të thjeshtë: asgjësimi dhe shkatërimi i qenies shqiptare në Kosovë. Italia fashiste, armike e përbetuar e shqiptarëve, ka qenë e detyruar ta pranojë karakterin shqiptar të trojeve shqiptare. Ndërkaq, pushteti popullor i sotëm, “çlirimtarët e popullit”, tenton që të gjitha lidhjet me Shqipërinë të këputen, duke tejkaluar okupatorin fashist. Këtë e ka treguar OZN-a me veprimet me terroriste që ua shkojnë atyre të Gestaposë. Diktatura dhjetëmujore me veprimet e veta terroriste e lë pas diktaturën fashiste. Ne të lirët, në malet tona të lira, jemi të autorizuar dhe të obliguar ta shprehim vullnetin e popullit të Kosovës. Për këtë arsye, në emër të popullit

shqiptar të Kosovës ngremë zërin dhe i drejtohem opinionit ndërkombëtar dhe botërisht deklarojmë se pa dëshirën tonë na e kanë imponuar bashkimin me Serbinë. Dëshira dhe vullneti ynë është bashkimi me Shqipërinë, me vëllezërit tanë, pa marrë parasysh se cili regjim është në pushtet, ngase kemi zakone të njëjta dhe kushte të njëjta morale e materiale. Dëshirojmë që t'ia shtrijmë dorën njëri-tjetrit sa më parë dhe ta shkundim pjesën e errësirës e të robërisë, frikës nga terrori, që vuajtëm nga okupatorët e ndryshëm duke përfshirë edhe këtë të sotmin, të Beogradit, dhe kuislingëve të Prizrenit. Ne nuk jemi kundër asnjë ideologjie, por as që përkrahim ndonjë ideologji. Ideologjia jonë është lufta për ekzistimin e popullit shqiptar. Jeta jonë dhe ekzistenca jonë mund të jenë të sigurta vetëm në një shtet shqiptar që do të përfshinë kufijtë e tokave shqiptare.

Sa i përket pakicës serbë të lindur në Kosovë, që jetojnë bashkërisht me popullin shqiptar, deklarojmë se do t'i kenë të drejtat e barabarta me shumicën shqiptare dhe në asnjë mënyrë nuk do të dallohen prej shqiptarëve. Ata malazezë që në Kosovë kanë ardhur pas vitit 1912 dhe në vitin 1918 si kolonistë, i këshillojmë të kthehen në vendet e veta nga e kanë prejardhjen, pasi që tokat që ata i kanë uzurpuar iu takojnë autoktonëve shqiptarë. Po ashtu deklarojmë se në Kosovë nuk ka asnjë malazez autokton. Të gjithë malazezët janë kolonizatorë. Këtë e dokumentojnë faktet e jo ne. Malazezët në Mal të Zi e kanë pushtetin dhe qeverinë e vet, ndërsa populli shqiptar, edhe pse është katër herë më i madh në numër se sa malazezët, këtë të drejtë nuk e gëzon. Sa u përket gënjeshtreve dhe thashethemeve tendencioze të terroristëve serbë e malazezë, deklarojmë se në batalionet tona nuk ka asnjë të huaj. Në të gjitha luftërat që i kemi zhvilluar këta 10 muajt e fundit në Kosovë nuk ka marrë pjesë asnjë i huaj. Andaj, njëherë e përgjithmonë deklarojmë se organizata jonë nuk ka lidhje me asnjë parti, organizatë të jashtme apo me qeverinë e vendit që Kosovës ia konteston mundësinë të jetojë dhe të bashkohet me Shqipërinë. Veçmas në mënyrë kategorike demantojmë që organizata jonë mund të këtë lidhje me drazhistët për të cilët na akuzojnë terroristët.

Vëllezër shqiptarë të Kosovës, regjimi terrorist me gënjeshtër po ju mashtron, nuk na mundëson që të lirë të votojmë dhe të vendosim për fatin tonë siç na kanë premtuar zhurmshëm në fillim, sepse e kanë ditur se do të votojmë për Shqipërinë e jo për Beogradin. Kuislingët e Prizrenit ishin të njoftuar me dëshirën dhe qëllimet e Titos, i cili para delegacioni shqiptar (prill 1945) kishte paraqitur kërkesën e tij që shqiptarët e Kosovës do të ishte më mirë të mbetën me Beogradin?! (Serbinë). Këta kuislingë që të bëheshin lajkatarë të Titos nxituan që sa më parë ta përmbushin dëshirën e tij.....<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Po aty.

Mund të këtë qenë edhe më i gjatë teksti në gjuhën shqipe, por deri në këtë masë është përkthimi në gjuhën serbe, të cilin ne e kemi në dorë. Pra, mbaron pa u përfunduar, gjë që e tregojnë disa pika në fund të tekstit....

### **Ne jemi vëllezërit tuaj në male duke luftuar me armë në dorë për lirinë e Kosovës**

Organët e UDB-së pas zbulimit të kësaj proklamate e burgosën Abdullah Musliun dhe shumë aktivistë të tjerë të NDSH-së, si Azem Moranën, Hasan Bilallin dhe të tjerët që i përkisnin grupit të Gjon Serreçit. Abdullahu u burgos më 28. XII. 1946 në cilësinë e kryetarit të Këshillit Popullor të Rrethit.

Proklamatën në fjalë, pas shumë trysnive dhe dhunës që ishte zbatuar nga organët e UDB-së në Prishtinë, Abdullahu më 10.IV.1947 në prani të majorit Miladin Paviçević e kishte pranuar si të veten.

Për këtë proklamatë nga Gjyqi i Qarkut në Prishtinë më 30. IV. 1947 Abdullah Musliu kishte marrë dënimin 10 vjet burgim të rëndë dhe 5 vjet heqje lirie politike e qytetare. 10 Ky aktgjykim ka marrë formën e plotë më 8.V.1947 pa pasur të drejtë mbrojtjeje. Më 31. XII. me vendimin e Presidiumit të Jugosllavisë nr. 5939\52 të datës 5.9.1952, pas disa ankesave për rishqyrtimin e aktgjykimit të bëra nga Abdullah Musliu, ai u lirua nga burgu pa pasur të drejta qytetare e politike.

Veç kësaj proklamate, po në këtë fond të Arkivit të Kosovës gjendet edhe një proklamatë që ka përmbajtje të përafërt me të parën. Siç duket, kjo mund të jetë forma më e shkurtër e Proklamatës, por që përmban edhe disa parulla. Në, megjithatë, mendojmë se është me interes që edhe këtë proklamatë ta japim në tërësi.

“Vëllezër kosovarë. Ne jemi vëllezërit tuaj që gjendemi nëpër malet e lira të Kosovës duke luftuar me armë në dorë ditë e natë për lirinë e Kosovës. Grushti që armiku po e merr nga ne i është i njohur tërë botës. Heronjtë që po vriten nga dora tradhtare e Partisë Komuniste të Jugosllavisë nëpër malet e fushat e Kosovës janë themelet e çelikut të Shqipërisë së vitit 1912 për bashkimin definitiv të Kosovës me Shqipërinë e vitit 1913 që do të jetë njëherë e përgjithmonë e pandashme.

Vëllezër kosovarë, qëllimi i luftës sonë është që të luftohen të gjithë ata që përpiqen për të na bërë të heqim dorë nga të drejtat tona të kufijve të vitit 1912. Ne jemi të vendosur për bashkimin me nënën Shqipëri që është e jona përkah gjuha dhe gjaku, si dhe t'i dëbojmë kolonistët që kanë ardhur në Kosovë pas vitit 1913 dhe vitit 1918, të shkojnë andej nga kanë ardhur. Ky është edhe qëllimi i bijve tuaj të shpërndarë nëpër malet e Kosovës që

derdhin gjakun për t'ua dhënë grushtin e fundit mbeturinave të ndyra që nuk na lejojnë të bashkohemi me nënë Shqipërinë në kufijtë e 1912-tës, pasi kjo e drejtë na është garantuar sipas Kartës së Atlantikut në San Francisko dhe në Konferencën e Paqes në Kretë.

Vëllezër shqiptarë, kemi parë deri tash mjaft tradhti e mashtrime nga tradhtarët dhe po ata me gjakun tuaj të derdhur po duan të ju lënë nën këmbën e Partisë Komuniste duke ua mbushur xhepat me dinarë të RFDJ-së. Nuk mund t'i durojmë tradhtitë e bëra nga tradhtarët. Mjaft është, nuk mund të durojmë më! Nuk mund të durojmë traditat e tradhtisë të këtyre tradhtarëve, që nuk mendojnë për popullin e varfër, por vetëm për kolltuk më të madh dhe, për t'i hyrë në hatër Titos, çdo ditë e gënjejnë popullin shqiptar, që sot në masë të madhe gjendet nëpër burgjet e Kosovës duke kërkuar të drejtat e veta që i takojnë sipas Kartës së Atlantikut që është dhënë nga përfaqësuesit e Anglisë dhe të Amerikës.

Vëllezër kosovarë, i gjithë Ballkani është organizuar për të nesërmen që po mbikëqyret nga forcat anglo-amerikane me urdhër të të cilave forcat ruse janë kthyer nga Iraku dhe pjesët e tjera të botës. Organizohuni, bashkohuni. Hiqni dorë nga spiunimi. Ai është në dëmin tuaj dhe bëhet nga ata që duan të ju shesin siç ju kanë shitur në vitin 1878 e deri më sot, që duan të ju lënë nën çizmen e Jugosllavisë. Shtrijani dorën ushtrisë suaj në malet e lira të Kosovës duke këputur nga dita në ditë zinxhirin e terroristëve të udhëhequr me argumentin e pesëcepëshit të kuq në ballë.<sup>10</sup>

“Roftë ushtria anglo-amerikane “

“Roftë bashkimi i Kosovës me Shqipërinë”

“Roftë liria dhe demokracia”

Edhe kjo proklamata që u përhap në popull menjëherë pas LDB-së dëshmon se krahu nacionalist i rezistencës kombëtare u angazhua në forma të ndryshme të rezistencës ushtarake dhe politike për bashkimin e trojeve etnike shqiptare në një shtet demokratik properëndimor. Ata për këtë qëllim zhvilluan një rezistencë aktive ushtarake e politike deri në çastin e fundit kur mundësitë e veprimit të tyre u ngushtuan nga ndjekjet e partizanëve, të OZN-së e të UDB-së. Në pamundësi të veprimit u detyruan ta braktisin vendin dhe të degdisen nëpër shumë shtete të Evropës e të botës, për ta vazhduar edhe atje aktivitetin e tyre në dobi të çështjes së Kosovës. Kështu veproi edhe nacionalisti i dëshmuar, intelektual i patrioti Adem Selimi-Gllavica, hartuesi i kësaj proklamate të Ballit Kombëtar, i cili një jetë të tërë ia kushtoi çlirimit dhe bashkimit të trojeve etnike shqiptare.

<sup>10</sup> Gjyqi Ushtarak Prishtinë 1945.-1947 Proklamata e “Ballit Kombëtar”.

*Dr. Sulltane KOJÇINI - UKAJ*

STATEMENT BY PATRIOTIC ADEM SELIMI-GLLAVICA (OCTOBER 1945)  
STUNNED THE FRAGILE COMMUNIST REGIME

**Summary**

During World War Two in Kosova operated two political forces – Communist that was fighting against Fascism, and nationalist that was fighting both fascism and communism. The nationalist forces aimed at establishing an Albanian democratic state in its ethnic borders supported mainly by pro-western allies, making use of the favorable circumstances prevailing during the activities of WWT. Communist forces were leaning on the Communist ideology and Soviet Union.

With the conclusion of the war, Communist forces came to power, whose deceiving actions caused a disappointment to those who trusted their empty promises during the WWT time discovering their true face following the Bujan's Conference. One of them was Abdullah Musliu, an antifascist 1941 fighter, a multiplier and distributor of the Proclamation.

Unsuitable circumstances that prevailed after 1945, and an intricate situation in Kosova pushed nationalist groups in Kosova withdraw to the mountains of Kosova in order to continue their active military and political resistance. A form of mobilization and resistance of the people against the new Communist authority was also a Proclamation written in October 1945 by the nationalist, intellectual and dedicated fighter Adem Selimi-Gllavica. The Proclamation was rich in content, with multifaceted segments from our national history and facts, including also messages. It had been distributed to those localities where members of NDSH (Albanian National Democratic) Party were active, such as Bresje, Bellaqefc, Lismir, etc. The content of the Proclamation had hugely disturbed the fragile Communist rule still unstable in Kosova, and forced it undertake urgent and fierce measures in order to prevent its distribution. The Proclamation proved that the nationalist wing of national resistance was engaged in various forms for the liberation of Kosova and unification with Albania. However, once the space of activity of the resistance narrowed by frequent and continued attacks waged by Communist forces (OZN and UDB), the nationalist groups were thinking of an exit strategy from Kosova with the aim of acting from outside, hoping on the support by Anglo-American allies who were unsatisfied with the division of spheres of interest in the Balkans. The author of Proclamation, Adem Selimi-Gllavica, acted in the same fashion, moving away to Australia, and dedicating all his life the settlement of the issue of Kosova and its unification with Albania.

